



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministerstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Gllgocit Burim Bujupi , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllgocit
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Nga:	Jeton Qela , Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Datë: 20.04.2026 VI-020-236
Zyrtarët përgjegjës:	Erbilin Hetemi , Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit Vjosa Ahmetaj , Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale
Lënda:	Shkresë përcjellëse
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 8, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe nenin 8 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, marrë parasysh se ky vendim nuk bënë pjesë të vendimet e përgjithshme të kuvendit të komunës vlerëson se:

- *Vendimi 02Nr.454/02-11327 për zgjedhjen e delegatëve për Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës, i miratuar me datë 30.03.2026 në Kuvendin e Komunës së Gllgocit, nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.*

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllgoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 154/02-11327 dt. 30/03/2026

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING		
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA		
KOSOVËS / VILAJETI I KOSOVËS / GOVERNMENT OF KOSOVA		
Ministrit të Pushtetit Lokal me Samouprave i Administracije Government Administration		
Data Date: 31-03-2026		
Organizata Organization: -VI- 020-236		
Nr. i Lendes No. of Documents: 31-03-2026		
Vlera Value:		

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenin 4 paragrafi 4.3 dhe 4.4 të statutit të Asociacionit të komunave të Kosovës Nr.237/15 datë 16.06.2015, vendimit nr.236/15 të datës 16.06.2015 të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës si dhe Kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës të datës 16.03.2026. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2026 miratoi këtë:

V e n d i m

Për zgjedhjen e Delegatëve për Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës

Neni 1

Më këtë Vendim miratohet zgjedhja e Delegatëve për Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës në këtë përbërje:

1. Artian Krasniqi
2. Egzona Tërdevci
3. Xhavit Drenori

Neni 2

Zgjedhja e Delegatëve për Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës do të bëhet në harmoni me statutin e Asociacionit të komunave të Kosovës Nr.237/15 datë 16.06.2015.

Neni 3

Kuvendi i Komunës i delegojnë për çdo 10 anëtarë një përfaqësues në Kuvendin e Asociacionit. Përfaqësuesit (anëtarët) e kuvendit mund të zëvendësohen me vendim të Kuvendit të Komunës, por në bazë të dispozitave të paragrafit 4.3 të nenit 4 të statutit të Asociacionit të komunave të Kosovës Nr.237/15 datë 16.06.2015.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse Kuvendi Komunal dhe Zyra e Kryetarit.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



ARSYETIM

Komuna e Drenasit në harmoni me statutin e Asociacionit të Komunave të Kosovës Nr.237/15 datë 16.06.2015 dhe kërkesës së këtij Asociacioni të datës 16.03.2026 ka për obligim zgjedhjen e Delegatesve për Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës, ku duke marrë parasysh këtë Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi dhe nevojës për përzgjedhjen e përfaqësuesve në fjalë që synon adresimin dhe zgjedhjen e problemeve në nivel lokal të votohet ky propozim vendim.